

**ASSIST sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

## **PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 19

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Assist sh.p.k

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Assist sh.p.k ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjëstë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet më datën 31 dhjetor 2016, nuk kanë qenë të audituara.

### Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Assist sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega Shqipëri

*Ernst & Young Certified Auditor*

27 korrik 2018  
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Mario Vangjel".

**ASSIST sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar  
 më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	11,800,140	2,441,239
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	224,872,827	9,060,410
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	26,253,636	33,170,204
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	59,597,555	34,133,998
Inventari	8	-	500,000
Aktive tatimore të shtyra	26	1,953,102	-
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		<b>324,477,260</b>	<b>206,727,592</b>
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Shpenzime të shtyra	9	180,835,696	127,421,741
Aktive afatgjatë materiale	10	52,009,332	38,697,157
Aktive afatgjatë jomateriale	11	153,098	-
<b>Total aktive afatgjatë</b>		<b>232,998,126</b>	<b>38,697,157</b>
<b>Total aktive</b>		<b>557,475,386</b>	<b>245,424,749</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregëtare	12	31,304,150	15,484,629
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	17,955,053	503,367
Detyrime tatimore	14	31,133,604	2,129,391
Të tjera detyrime	15	53,476,512	4,614,118
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>133,869,319</b>	<b>22,731,505</b>
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua nga palët e lidhura	16	328,386,500	220,424,900
<b>Total detyrime afatgjatë</b>		<b>328,386,500</b>	<b>220,424,900</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>462,255,819</b>	<b>243,156,405</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar	17	1,400,000	1,400,000
Rezerva ligjore		52,060	-
Rezerva të tjera		816,284	(172,846)
Fitimi i ushtrimit		92,951,223	1,041,190
<b>Total kapitali</b>		<b>95,219,567</b>	<b>2,268,344</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>557,475,386</b>	<b>245,424,749</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**ASSIST sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	664,482,653	42,326,969
Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit, neto	19	(2,666,010)	(280,167)
<b>Shpenzime administrative dhe të tjera</b>		<b>(110,702,167)</b>	<b>(26,244,226)</b>
1) Shpenzime administrative	20	(91,505,537)	(22,133,309)
2) Të tjera shpenzime	21	(19,196,630)	(4,110,917)
<b>Shpenzime të personelit</b>	22	<b>(433,808,952)</b>	<b>(15,791,968)</b>
1) Paga dhe shpërblime		(375,806,741)	(13,599,104)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(58,002,211)	(2,192,864)
	10/1		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1	(11,207,582)	(1,625,875)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(16,655)	(107)
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime financiare, neto</b>	24	<b>3,601,262</b>	<b>2,984,744</b>
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njesitë ekonomike brenda grupit)		(1,154,338)	(558,844)
2) Të ardhura të tjera financiare		4,755,600	3,543,588
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>109,682,549</b>	<b>1,369,370</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	25	<b>(16,731,326)</b>	<b>(328,180)</b>
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(18,684,428)	(328,180)
2) Shpenzimi i tatimit të shtyrë	26	1,953,102	-
<b>Fitimi vitit</b>		<b>92,951,223</b>	<b>1,041,190</b>
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>92,951,223</b>	<b>1,041,190</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**ASSIST sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / (Humbja) e mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>1,400,000</b>	-	-	(172,846)	<b>1,227,154</b>
Fitimi vitit	-	-	-	1,041,190	<b>1,041,190</b>
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	(172,846)	172,846	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>1,400,000</b>	-	(172,846)	<b>1,041,190</b>	<b>2,268,344</b>
Fitimi vitit	-	-	-	92,951,223	<b>92,951,223</b>
Lëvizjet përmes kapitalit	-	52,060	989,130	(1,041,190)	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,400,000</b>	<b>52,060</b>	<b>816,284</b>	<b>92,951,223</b>	<b>95,219,567</b>

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori Franco Fradiani dhe janë firmosur më 27 Mars 2018 si më poshtë:



Administrator  
 Franco Fradiani



**Mazars Shpk**  
 Rr. Emin Durekri, Patë Bujshet  
 No.5, 1000, Tirana, Albania  
 phone: +355 47 27 80 15  
 www.mazars.al . info@mazars.al

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**ASSIST sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi vitit pas tatimit	92,951,223	1,041,190
Shpenzimet financiare jomonetare	(2,853,819)	(2,873,910)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	17,091,326	298,180
Shpenzime amortizimi	11,207,582	1,625,875
<b>Lëvizjet në kapitalin qarkullues</b>		
Rritje në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(234,359,405)	(76,340,012)
Rënie/(rritje) në inventarë	500,000	(500,000)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(258,819,479)	17,778,970
Rritje në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(53,413,955)	(127,421,741)
Rritje në detyrime për punonjësit	355,786,957	4,491,249
<b>Mjete monetare përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(71,909,570)</b>	<b>(181,900,199)</b>
Tatim fitimi i parapaguar	(4,514,092)	-
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(76,783,662)</b>	<b>(181,900,199)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(24,501,247)	(40,323,032)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	(171,608)	-
<b>Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin e investimit</b>	<b>(24,672,855)</b>	<b>(40,323,032)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara	112,717,200	223,967,115
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti i financimit</b>	<b>112,717,200</b>	<b>223,967,115</b>
<b>Rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>	<b>11,260,683</b>	<b>1,743,884</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre 1 janar	2,441,239	1,367,033
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(1,901,781)	(669,678)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor</b>	<b>4 11,800,141</b>	<b>2,441,239</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1. Informacion i përgjithshëm**

Assist shpk është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të rregjistrimeve më datë 17 Nëntor 2015 me NIPT L52317008R. Selia e shoqërisë është: Rruga "Emin Duraku", Pall "Binjaket", Nr.5, Tirane, Shqipëri.

Kapitali i shoqërisë është 1,400,000 lekë i ndarë në 1 kuotë. Administratori i shoqërisë është z.Franco Fradiani.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është shoqëria e huaj Assist s.p.a e cila zotëron 100% të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është studimi, konsulenca, projektimi, realizimi dhe shërbimet e manaxhimit të kompanive, për ndërmarrjet dhe entet drejtuese për të mbështetur shitjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve të vetë klientëve.

Më 31 dhjetor 2017 shoqëria kishte 604 punonjës, (2016: 81 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare.

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)****2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)**

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobije dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

##### iii. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5. Permiresime te kapitalizuara te ambienteve me qera

Permiresime te kapitalizuara te ambienteve me qera amortizohen per me te voglen mes jetegjatesise se kontrates se qerese dhe jetegjatesise se permiresimve te kapitalizuara.

#### 3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.10. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016:15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

**3.11. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale dhe qeveritare janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

**3.12. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

**3.13. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	11,768,370	2,441,239
Mjete monetare në arkë	31,770	-
	<u><b>11,800,140</b></u>	<u><b>2,441,239</b></u>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	224,872,827	-
Klientë për të ardhura të përlogaritura	-	9,060,410
	<u><b>224,872,827</b></u>	<u><b>9,060,410</b></u>

**6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Assist SPA	5,809,117	33,170,204
Të arkëtueshme tregtare nga Assist BEEWEEB	18,126,403	-
Të arkëtueshme tregtare për të ardhura të përlogaritura nga Assist BEEWEEB	2,318,116	-
	<u><b>26,253,636</b></u>	<u><b>33,170,204</b></u>

**7. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH	59,585,390	34,129,423
Detyrime doganore	12,165	4,575
	<u><b>59,597,555</b></u>	<u><b>34,133,998</b></u>

**8. Inventari**

Inventari më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Materiale të tjera ndihmëse	-	500,000
	<u><b>-</b></u>	<u><b>500,000</b></u>

**9. Shpenzime të shtyra**

Shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme për pershtatje ambientesh punuese	172,681,796	121,868,148
Parapagime për garanci qeraje	7,934,239	5,501,176
Të tjera shpenzime të periudhave të ardhshme	219,661	52,417
	<u><b>180,835,696</b></u>	<u><b>127,421,741</b></u>

## 10. Aktive afatgjata materiale

	Automjetet	Mobilje dhe orendi	Pajisje kompjuterike	Të tjera	Totali
<b>Kosto</b>					
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2016</b>	-	<b>25,289,048</b>	<b>14,624,904</b>	<b>409,080</b>	<b>40,323,032</b>
Shtesa	1,403,430	5,487,508	15,044,093	2,566,216	24,501,247
Nxjerrje jashtë përdorimit					-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,403,430</b>	<b>30,776,556</b>	<b>29,668,997</b>	<b>2,975,296</b>	<b>64,824,279</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>					
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2016</b>	-	<b>(1,091,328)</b>	<b>(514,093)</b>	<b>(20,454)</b>	<b>(1,625,875)</b>
Amortizimi i vitit	-	(5,414,608)	(5,293,962)	(480,502)	(11,189,072)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2017</b>	-	<b>(6,505,936)</b>	<b>(5,808,055)</b>	<b>(500,956)</b>	<b>(12,814,947)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>					
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	-	<b>24,197,720</b>	<b>14,110,811</b>	<b>388,626</b>	<b>38,697,157</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>1,403,430</b>	<b>24,270,620</b>	<b>23,860,942</b>	<b>2,474,340</b>	<b>52,009,332</b>



**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**11. Aktive afatgjata jomateriale**

	<b>Licenca Windows</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>		
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2016</b>	-	-
Shtesa	171,608	171,608
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>171,608</b>	<b>171,608</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>		
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2016</b>	-	-
Amortizimi i vitit	(18,510)	(18,510)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>(18,510)</b>	<b>(18,510)</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2016</b>	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>153,098</b>	<b>153,098</b>

**12. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Furnitorë vendas	25,381,554	6,822,325
Furnitorë të huaj	5,422,174	8,596,323
Furnitorë vendas për fatura të pambërritura	500,422	65,981
	<b>31,304,150</b>	<b>15,484,629</b>

**13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura**

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Të pagueshme tregtare Assist S.p.a.	13,648,283	503,367
Të pagueshme tregtare Assist Doo	4,306,770	-
	<b>17,955,053</b>	<b>503,367</b>

**14. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Tatim fitimi	14,170,336	288,180
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	12,801,867	1,422,814
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	4,107,224	391,904
Tatimi në burim	54,177	26,493
	<b>31,133,604</b>	<b>2,129,391</b>

**ASSIST sh.p.k**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**  
*(Vlerat janë në Lek)*

**15. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Pagat e punonjësve	39,586,717	4,535,618
Detyrime për pushime të perlllogaritura	6,420,680	-
Detyrime për bonuse të perlllogaritura	6,600,000	-
Të tjera	869,115	78,500
	<u><b>53,476,512</b></u>	<u><b>4,614,118</b></u>

**16. Hua nga palët e lidhura**

Hua nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Financim Assist S.p.a.	328,386,500	220,424,900
	<u><b>328,386,500</b></u>	<u><b>220,424,900</b></u>

**17. Kapitali**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 1,400,000 Leke i ndarë në 1 kuote, i zotëruar 100% nga shoqëria italiane "Assist spa".

**18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Sherbim Call Center	662,147,973	33,266,559
Shërbim Call Center të perlllogaritura	2,334,680	9,060,410
	<u><b>664,482,653</b></u>	<u><b>42,326,969</b></u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
<b>Rakordimi i të ardhurave me FDP-në</b>	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	689,101,230
Autofatura të deklaruara për blerje shërbime nga jashtë shtetit	(24,618,577)
<b>Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH</b>	<u><b>664,482,653</b></u>
Shërbime	664,482,653
<b>Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP</b>	<u><b>664,482,653</b></u>
Fitim nga këbimet valutore	6,366,636
<b>Total të ardhura të deklaruara FDP-në e Tatim fitimit</b>	<u><b>670,849,289</b></u>

**19. Të ardhura/(shpenzime) të tjera të shfrytëzimit, neto**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Humbje nga këmbimet valutore	(4,277,046)	(1,207,233)
Fitim nga këmbimet valutore	1,611,036	927,066
	<b>(2,666,010)</b>	<b>(280,167)</b>

**20. Shpenzime administrative**

Në këtë zë paraqiten amortizimi dhe kostoja e shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Shpenzimet paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Shpenzime amortizimi për përshtatje të ambienteve	36,217,894	1,949,892
Qira zyra	23,480,244	14,469,846
Shërbime teknike	16,473,282	-
Energji elektrike	5,299,087	867,640
Shërbim konsulte rekrutim stafi	4,495,469	3,429,694
Pajisje ndihmëse	3,144,185	987,237
Shërbim interneti	1,863,976	-
Shpenzime telekomunikacioni	348,400	413,000
Shpenzime trajnim për sigurinë në punë	183,000	16,000
	<b>91,505,537</b>	<b>22,133,309</b>

**21. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Konsulence ekonomike	3,793,464	1,049,356
Shpenzime transporti	3,544,906	-
Shpenzime pritjeje	2,867,712	103,970
Te tjera	1,235,265	544,369
Konsumi i ujit te zyrave	946,275	-
Shpenzime postare dhe telefonie	940,339	186,497
Licensa softwer	974,157	10,483
Kousulencë juridike	805,470	277,130
Shpenzime publicitare	737,131	-
Shpenzime mirmbajtjeje	724,367	-
Qera Hapsire publicitare	674,586	588,125
Shpenzime bankare	599,405	379,765
Dieta	352,982	-
Shpenzime parkimi	245,400	-
Kancelari	238,222	101,077
Qera Pajisje	159,332	41,400
Taksa vendore	134,000	67,000
Dhurata	113,600	-
Prime Sigurimi	110,017	129,107
Konsulence per studim tregu	-	632,638
	<b>19,196,630</b>	<b>4,110,917</b>

**22. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Shpenzime për paga	362,786,061	13,599,104
Shpenzime për sigurime shoq e shënd	58,002,211	2,192,864
Shpenzime per shperblime te perllogaritura	6,600,000	-
Shpenzime per pushime te perllogaritura	6,420,680	-
	<b>433,808,952</b>	<b>15,791,968</b>

**23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit**

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Gjoba dhe penalitete	16,655	107
	<b>16,655</b>	<b>107</b>

**24. Shpenzime financiare, neto**

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
Shpenzime për interesa	(1,154,338)	(558,844)
Të ardhura nga këmbimet valutore	4,755,600	3,543,588
	<b>3,601,262</b>	<b>2,984,744</b>

**25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>109,682,549</b>	<b>1,369,370</b>
<b>Shpenzime të panjohura të tjera</b>	<b>14,880,306</b>	<b>991,340</b>
Shpenzime pritje dhe përcjellje	874,265	-
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	16,655	107
Dhurata	113,600	-
Shpenzime interesash të panjohura	70,795	519,357
Provizione për bonuse dhe pushime të përlllogaritura	13,020,680	-
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	784,312	471,876
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>124,562,855</b>	<b>2,360,710</b>
Humbje fiskale e mbartur	-	(172,846)
<b>Fitimi i tatueshëm</b>	<b>124,562,855</b>	<b>2,187,864</b>
<b>Tatim fitimi 15%</b>	<b>18,684,428</b>	<b>328,180</b>
<b>Të ardhura nga tatimi i shtyrë</b>	<b>(1,953,102)</b>	<b>-</b>
	<b>92,951,223</b>	<b>1,041,190</b>

## 26. Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i shtyrë llogaritur për pushimet dhe bonuset e punonjësve të pa dhëna	1,953,102	-
<b>Aktiv tatimor i shtyre</b>	<b>1,953,102</b>	<b>-</b>
	Paraqitur në Pasqyrën e Performancës	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatim fitimi i shtyrë llogaritur për pushimet dhe bonuset e punonjësve të pa dhëna	1,953,102	-
<b>Shpenzim i tatimit të shtyrë</b>	<b>1,953,102</b>	<b>-</b>

Rakordimi i tatimit të shtyrë paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Balanca me 1 janar</b>	-	-
Tatimi i shtyrë e ardhur (shpenzim) gjatë vitit	1,953,102	-
<b>Balanca më 31 dhjetor</b>	<b>1,953,102</b>	<b>-</b>
<b>Tatim fitimi i Shtyrë</b>		
Përlllogaritje Pushime dhe bonuse 2017	13,020,680	-
<b>Total</b>	<b>13,020,680</b>	<b>-</b>
<b>Tatim fitimi i shtyrë 15%</b>	<b>1,953,102</b>	<b>-</b>

**27. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</b>		
Assist spa	342,034,783	220,928,267
Assist Doo	4,306,770	-
	<b>346,341,553</b>	<b>220,928,267</b>
	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Të arketueshme nga palët e lidhura</b>		
Assist BEEWEEB	18,126,403	-
Assist SPA	5,809,117	33,170,204
Te ardhura te perlogaritura nga Assist BEEWEEB	2,318,116	-
	<b>26,253,636</b>	<b>33,170,204</b>

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</b>		
Assist spa	13,297,727	558,800
Assist DOO	4,329,892	-
	<b>17,627,619</b>	<b>558,800</b>
	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Shitje për palët e lidhura</b>		
Assist spa	93,975,048	33,266,559
Assist BEEWEEB	18,228,862	-
Të ardhura te perlogaritura nga Assist BEEWEEB	2,318,116	-
	<b>114,522,026</b>	<b>33,266,559</b>

**28. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**29. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.